



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA  
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD  
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



## RAPORT I PARË PERIODIK

Për lëvizjet e treguesve operativ, financiar dhe të  
investimeve kapitale të KRU-ve  
në dritën e efekteve nga tarifat e reja 2009-2011

---

Periudha Raportuese: Janar-Maj, 2009

*Hartuar nga:  
Departamenti për Financa dhe Tarifa i ZRRUM*

Gusht 2009

## Parathënie

Ky raport paraqet një pasqyrë të treguesve kryesor operativ dhe financiar të shtatë KRU-ve si dhe investimet kapitale të kryera nga to në periudhën: 1 janar 2009 deri më 31 maj 2009. Qëllimi i këtij raporti është i trefishtë:

- (i) Të jepet një informacion për trendin e treguesve operativ dhe financiar të KRU-ve dhe në veçanti për investimet kapitale të ndërmarra nga KRU-të, që do ti shërbente ZRRUM dhe palëve tjera të interesit;
- (ii) Të krahasohen treguesit e punës së KRU-ve me objektivat e përcaktuara në planet e tyre të biznesit dhe në rast të shmangieve të mëdha në këtë plan të mundësohet ndërmarrja me kohë e veprimeve korrektuese;
- (iii) Të shikohen efektet potenciale të tarifave të reja të shërbimit të aprovuara nga ZRRUM për periudhën e ardhshme 3-vjeçare (2009-2011) në treguesit e punës së KRU-ve, dhe në veçanti efektet e tarifave në ndërmarrjen e investimeve kapitale të KRU-ve.

Prezantimi i të dhënave në këtë raport përmbledh tri shtylla kryesore: a) të dhënat e realizuara të vitit 2008, b) të dhënat e tilla të planifikuara nga kompanitë dhe të lejuara nga ZRRUM për vitin 2009, dhe c) të dhënat e realizuara për treguesit operativ dhe financiar si dhe të investimeve kapitale për 5 muajt e parë të vitit 2009.

Të dhënat për këtë raport janë përmbledh, përpunuar dhe analizuar nga Departamenti për Financa dhe Tarifa në ZRRUM gjatë muajt qershor 2009, në një proces i cili ka përfshi tri faza të ndara, të cilat janë realizuar si vijon: (i) fillimisht janë zhvilluar vizitat nëpër KRU, (ii) pastaj janë përpunuar dhe analizuar të dhënat të marra, dhe (iii) është përpiluar ky raporti i parë periodik i është planifikuar të pasohet me një tjetër gjatë gjysmës së dytë të muajt tetor 2009 me qëllim të monitorimit efektiv të performancës së KRU-ve në kuadër të ciklit tarifor.

## PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| 1. HYRJE.....  | 4  |
| 2. ASPEKTET ADMINISTRATIVE.....  | 4  |
| 3. METODOLGJIA TARIFORE.....   | 5  |
| 4. LËVIZJET E TREGUESEVE OPERATIV, FINANCIARË DHE INVESTIV NË 5 MUAJT E 2009 ... | 6  |
| 4.1. UJI I PRODHUAR KUNDREJT SASISË SË FATURUAR TË UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA      | 6  |
| 4.1.1. TË DHËNAT E PRODHIMIT DHE FATURIMIT SIPAS KRU-ve.....                     | 8  |
| 4.1.2. TË DHËNAT E PRODHIMIT DHE FATURIMIT NË NIVEL TË SEKTORIT .....            | 10 |
| 4.1.3. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE PËR UJIN E PRODHUAR DHE TË FATURUAR ....   | 11 |
| 4.2. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE .....                                       | 13 |
| 4.2.2. SHPENZIMET OPERATIVE NË NIVEL TË SEKTORIT .....                           | 16 |
| 4.2.3. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE PËR SHPENZIME OPERATIVE PËR KRU-TË .....   | 17 |
| 4.3. TË DHENAT E FATURIMIT DHE INKASIMIT.....                                    | 18 |
| 4.3.1. FATURIMI DHE INKASIMI SIPAS KRU-ve .....                                  | 18 |
| 4.3.2. TË DHËNAT FATURIM DHE INKASIM NË NIVEL TË SEKTORIT.....                   | 22 |
| 4.4. ANALIZA E INVESTIMEVE KAPITALE.....   | 23 |
| 4.4.2. TË DHËNAT SEKTORIALE TË PËRGJITHSHME PËR INVESTIME KAPITALE.....          | 27 |
| 5. KONKLuzionET ME REKOMANDIME .....   | 28 |

## 1. HYRJE

Bazuar në planin e punës për vitin 2009, Departamenti për Financa dhe Tarifa (DFT) si njësi organizative i cili vepron në kuadër të Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM), ka planifikuar dhe ndërmarrë veprimet e duhura për të mbledhur, përpunuar, analizuar dhe raportuar për efektet 4-5 mujore të tarifave të vitit 2009, të përcaktuara për të gjitha kompanitë e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit (KRU-të) të licencuara nga ZRRUM.

Për këtë qëllim janë organizuar vizita tek KRU-tët të cilat janë përgatitur dhe realizuar nga analistët e DFT-ës, të cilët kanë propozuar dhe dakorduar me menaxhmentet e KRU-ve; qëllimin e vizitës, nivelin e takimeve, datat e takimeve dhe pyetësonin e dizajnuar paraprakisht për tu plotësuar për këtë qëllim.

Me këta pyetësorë janë marrë të dhëna/shënime për një grup të treguesve kryesorë operativo-financiarë dhe të investimeve kapitale të realizuara për periudhën e trajtuar.

Edhe pse KRU-të janë paralajmëruar paraprakisht për kohën dhe qëllimin e vizitës, që të gjitha nuk kanë pasur të dhëna të përpunuara për këtë periudhë. Shumica prej tyre të dhënat e kërkuara i kanë pasur për 4 muaj, dhe vetëm dy nga to për 5 muaj. Ndërsa të dhënat për investime kapitale kanë qenë të përmbledhura te të gjitha kompanitë për 5 muajt e parë të këtij viti.

Kompania e Prishtinës dhe Prizrenit të gjithë treguesit e dhënë i kanë pasqyruar për pesë mujorin e parë të vitit 2009.

## 2. ASPEKTET ADMINISTRATIVE

Ndërmarrja e kësaj iniciative është mbështetur edhe në Ligjin Nr. 03/L-086, *Mbi Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49, për Veprimtaritë e Shërbimeve të Ujësjellësve, Kanalizimeve dhe të Mbeturinave*, dhe të Rregullës R-02/UeK, të datës 12.08.2008, *Për Përcaktim të Tarifave të Shërbimit për Shërbimet e Ujësjellësit, Ujërave të zeza, dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë*, neni 26, pika a. dhe b. Konform akteve të mësipërme, ndërmarrja e një aktiviteti monitorues është përcaktuar edhe me Politikën Tarifore për Shërbimet e Ujit të nxjerrë nga ZRRUM në shtator 2007, si dhe me Planin e Punës për Vitin 2009 (pikat (ii) departamentet e ZRRUM-it, Departamenti për financa dhe tarifa rregullatore, synimi V, nga pika (i) gjerë te pika (vii), Raportet e veçanta përfundimtarë të vlerësimit dhe përcaktimit të tarifave afatmesme 2009-2011).

Identifikimi me kohë i problemeve dhe informimi i ndërsjellë është shumë me rëndësi për përmbushjen e caqeve të përcaktuara, ose për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për korrigjim eventual të politikave për përcaktim të tarifave dhe eventualisht për ndërmarrjen e veprimeve menaxheriale nëpër KRU-të e caktuara.

Nga aspekti administrativ DFT/ZRRUM mund të ndërmerr veprime të caktuara administrative me qëllim të përshtatjes së rrethanave të reja të krijuara nga procesi tarifor, të cilat mund të jenë të ndikuar nga faktorët e brendshëm apo edhe të jashtëm.

Të gjitha veprimet eventuale në pajtim me rrethanat apo situatat e caktuara që mund të paraqiten, do të ndërmerren pas konsultimeve të ndërsjella me palët e interesuara.

### 3. METODOLGJIA TARIFORE

Politika dhe metodologjia e përdorur për përcaktim të tarifave 2009-11, ishte e ndryshme nga ajo e përdorur në dy proceset paraprake. Në fakt, DFT/ZRRUM mbështetur nga konsulentët ndërkombëtar ka zhvilluar metodologjinë e re tarifore bazuar në praktikën e mira të rregullatorëve tjerë ekonomik të shërbimeve të ujit, para së gjithash të atyre të Britanisë së Madhe duke pasur parasysh specifikat tona aktuale. Kjo metodologji bazohet në këto kategori vijuese: (i) mbulimin e shpenzimeve operative dhe të investimeve kapitale, (ii) marrjen parasysh të shumës së amortizimit për asetet jo-infrastrukturore, (iii) përcaktimin e vlerës rregullatore të kapitalit, (iv) normën e kthimit në vlerën rregullatore të kapitalit, (v) fillimin e mbajtjes së kontabilitetit rregullator për çdo kosto qendër veç e veç, me theks të veçantë të shërbimet ujësjellësit dhe atë të kanalizimit etj.

Përdorimi i kategorive të këtilla ekonomike ka ndikuar që edhe politikat tona tarifore të ndryshojnë dhe ti përshtaten rrethanave të reja të cilat kërkojnë monitorim periodik të lëvizjeve ekonomike të treguesit e tillë kryesorë të kompanive. Përcjellja e ndikimeve të tarifave të përcaktuara për periudhën e ardhshme tre vjeçare 2009-2011, do të realizohet me vizita monitoruese-konsultative në periudha të caktuara kohore, brenda një viti kalendarik.

Kalimi nga sistemi i përcaktimit të tarifave 1-vjeçare, në atë 3-vjeçare ka ndikuar në ndërrimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave që llogaritet si pikë kthese për fillimin e realizimit të investimeve kapitale, me të cilat sigurohet një burimeve i mundshëm i financimit në shërbimet e ujit, si; zëvendësim dhe zgjerim të rrjetit të ujësjellësit, ngritjen e nivelit të shërbimit etj.

Metodologjia e përcaktimit të tarifës bazohet mbi vlerën e tarifës e cila duhet të jetë e barabartë ose më e lartë se shpenzimet marginale afatgjate të investimeve të nevojshme kapitale, të llogaritura mbi bazën sasiore dhe cilësore të shfrytëzuesve të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Procesi tariforë zhvillohet duke marrë parasysh kostot operative-financiare, nga të cilat po numërojmë: kostot e kaptimit, prodhimit dhe shpërndarjes së ujit të pijes, kostot e grumbullimit të ujërave të zeza, kostot e personelit, riparimet, investimet në infrastrukturën nëntokësore dhe mbi tokësore, amortizimin e aseteve jo-infrastrukturore, përcaktimin e vlerës rregullatore të kapitalit dhe në kuadër të kësaj llogaritjen e normës së kthimit në kapital etj., që të gjitha këto futen në proporcion me sasinë e ujit të prodhuar.

Për çdo kompani për të cilat janë përcaktuar tarifat janë përgatitur pasqyrat e të hyrave të planifikuara në bazë të parasë së gatshme në të cilat është llogaritur edhe profiti i mundshëm në fund të çdo viti afarist, të cilat kompanitë duhet ti investojnë për ta zgjeruar bazën e tyre materiale, me të dhënat planifikuara të cilat janë akorduar mes DFT/ZRRUM dhe KRU-ve.

Mos përmbushja e planeve investive kapitale, të cilat në vete përmbajnë profitin e kompanisë, ka për reperkusion rishikimin e tarifave për vitet pasuese, pasi që mund të

konsiderohet se pa të drejtë janë ngarkuar konsumatorët me një pjesë të tarifës e cila nuk po përdoret për qëllimin e parapërcaktuar.

Zgjerimi i bazës së kostove të reja të cilat e kanë ngarkuar tarifën, sikurse theksuam edhe ma lartë u kanë dhënë të drejtë kompanive që mjetet e fituara financiare ti përdorin për investime kapitale, sikurse edhe ato të tjerat të huazuara mbi bazën e kredive komerciale apo edhe të tjerave.

Këto veprime merren në koordinim të ngushtë me menaxhmentet e kompanive (duke saktësuar afatet kohore paraprake, metodologjinë, treguesit) dhe përmbillen me përpilimin e një raporti që pasqyron specifikat e çdo kompanie.

Nga monitorimi i lëvizjeve të tilla do të mundohemi me i parapengur ndikimet eventuale negative që mund të jenë shkaktarë të mosrealizimit të planeve të kompanive gjatë kësaj periudhe 3-vjeçare dhe ndërmarrjen e veprimeve adekuatë korigjuese në pajtim me rrethanat e reja të krijuara.

#### **4. LËVIZJET E TREGUESEVE OPERATIV, FINANCIARË DHE INVESTIV NË 5 MUAJT E 2009**

Treguesit e identifikuar si kryesorë gjatë vizitave të bëra të analistëve të DFT/ZRRUM nëpër KRU mbi bazën e të dhënave për 4-5 muaj të këtij viti të krahasueshme me shumën e aprovuar nga DFT/ZRRUM të po këtij viti dhe ato të realizuar gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2008, janë:

- sasia e ujit të prodhuar,
- sasia e ujit të faturuar,
- shuma e inkasimit
- shuma e shpenzimeve operative,
- numri dhe shuma e projekteve të realizuar dhe ato në realizim e sipër, etj.

Edhe pse emërtimi i këtij dokumenti është *raport i parë periodik i vitit 2009 për të dhënat 5 mujore*, në fakt shumica e KRU-ve të dhënat i kanë pasur të përmbledhura për katër muaj. Prandaj, ne kemi dhënë sqarimet e duhura për të mos kuptuar gabimisht të dhënat dhe konkluzionet e nxjerra.

Në vijim do të pasqyrojmë të dhënat në formë tabelore për çdo KRU veç e veç dhe në fund të dhënat e përbashkëta për sektorin për atë grup të dhënave, me qëllim të krijimit të një pasqyre të plotë. Të njëjtat do ti ofrojmë edhe në formë grafike, dhe do të komentohen në pika të veçanta dhe të përgjithshme.

##### **4.1. UJI I PRODHUAR KUNDREJT SASISË SË FATURUAR TË UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA**

Të dhënat e mbledhura për këto grupime të dhënash dhe për të tjerat do ti paraqesim në formë tabelore të thjeshtësuar, me qëllim të krahasimit më të lehtë dhe verifikimit të dhënave të marra. Të dhënat e tilla janë për çdo KRU veç e veç dhe të përmbledhura për sektorin në fund.

Për çdo grupim të dhënave do të nxjerrjen konkluzionet e veçanta për kompanitë individuale me qëllim që të ndikohet në përmirësimin e performances së tyre gjer në fund të këtij viti kalendarik.

| Nr. Rendi                   | Emrtimi i KUR-ve   | Të dhënat                 | Njësia | Historike 2008 | Aprovuara nga ZRRUM 2009 | Realizuar 2009 |
|-----------------------------|--|---------------------------|--------|----------------|--------------------------|----------------|
| 1                           | <b>"Prishtina" Sh.A. Prishtinë</b><br>(të dhënat 5 mujore)         | Uji i prodhuar            | m3     | 17,013,519     | 18,595,000               | 18,338,448     |
|                             |  | Uji i faturuar            |        | 9,064,973      | 10,273,738               | 8,652,002      |
|                             |  | Ujrat e zeza të faturuara |        | 7,003,825      | 8,732,677                | 6,498,133      |
| 2                           | <b>"Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë</b><br>(të dhënat 4 mujore)         | Uji i prodhuar            | m3     | 5,602,010      | 5,526,667                | 5,766,664      |
|                             |  | Uji i faturuar            |        | 2,811,834      | 3,100,654                | 2,835,968      |
|                             |  | Ujrat e zeza të faturuara |        | -              | 1,433,416                | 1,267,894      |
| 3                           | <b>"Hidrodrini" Sh.A. Pejë</b><br>(të dhënat 4 mujore)             | Uji i prodhuar            | m3     | 10,121,882     | 10,000,000               | 9,455,443      |
|                             |  | Uji i faturuar            |        | 2,579,112      | 2,475,040                | 2,358,907      |
|                             |  | Ujrat e zeza të faturuara |        |                | 1,039,517                |                |
| 4                           | <b>"Radonqi" Sh.A. Gjakovë</b><br>(të dhënat 4 mujore)             | Uji i prodhuar            | m3     | 5,682,591      | 5,919,267                | 4,718,825      |
|                             |  | Uji i faturuar            |        | 2,132,240      | 2,933,833                | 1,990,442      |
|                             |  | Ujrat e zeza të faturuara |        |                | 1,628,277                | 1,429,241      |
| 5                           | <b>"Hidroregjioni Jugor" Sh.A. Prizren</b><br>(të dhënat 5 mujore) | Uji i prodhuar            | m3     | 5,004,167      | 5,024,090                | 6,257,309      |
|                             |  | Uji i faturuar            |        | 2,922,140      | 3,231,221                | 2,747,065      |
|                             |  | Ujrat e zeza të faturuara |        |                | 2,972,723                |                |
| 6                           | <b>"Bifurkacioni" Sh.A. Ferizaj</b><br>(të dhënat 4 mujore)        | Uji i prodhuar            | m3     | 1,613,992      | 1,980,745                | 1,706,872      |
|                             |  | Uji i faturuar            |        | 847,382        | 1,081,776                | 687,076        |
|                             |  | Ujrat e zeza të faturuara |        |                | 912,844                  |                |
| 7                           | <b>"Hidromorava" Sh.A. Gjiilan</b><br>(të dhënat 4 mujore)         | Uji i prodhuar            | m3     | 1,949,299      | 2,956,667                | 2,233,832      |
|                             |  | Uji i faturuar            |        | 979,092        | 1,736,653                | 981,769        |
|                             |  | Ujrat e zeza të faturuara |        |                | 1,580,355                |                |
| <b>Sasia e përgjithshme</b> |  | Uji i prodhuar            | m3     | 46,987,460     | 50,002,435               | 48,477,393     |
|                             |  | Uji i faturuar            |        | 21,336,773     | 24,832,914               | 20,253,229     |
|                             |  | Ujrat e zeza të faturuara |        | 7,003,825      | 18,299,808               | 9,195,268      |

Në vijim po i analizojmë shkurtimisht të dhënat e këtij grupimi të deklaruara nga KRU-të veç e veç dhe në fund të njëjtat po i komentojmë nga perspektiva e ZRRUM-it, duke nxjerrë konkluzione eventuale për të njëjtat.

#### 4.1.1. TË DHËNAT E PRODHIMIT DHE FATURIMIT SIPAS KRU-ve

- **KUR “PRISHTINA” Sh. A. Prishtinë**

KRU “Prishtina” Sh. A. Prishtinë nuk i ka përbushë asnjë nga treguesit e planifikuar gjatë 5 mujorit të parë të këtij viti. Prodhimi i afrohet sasisë së planifikuar dhe ka mbetur pa u realizuar vetëm për 1,38%. Faturimi i ujit të furnizuar nuk është realizuar nga ai i planifikuar për 15,78% si dhe ai i grumbullimit të ujërave të zeza ka ngecë pa u realizuar për 25,59% në krahasim me sasinë planifikuar për 5 muajt e parë të këtij viti.

Kur këto të dhëna i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shohim se kompania ka prodhuar ujë ma shumë gjatë vitit 2009 për 7,78%, dhe ka faturuar ma pak ujë për 4,56%. Po ashtu e njëjta ka grumbulluar ma pak ujë të zeza për 7,22% në krahasim me të dhënat e kësaj periudhe të vitit të kaluar.

Humbjet e ujit gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008 kanë qenë 46,72%, ndërsa gjatë të njëjtës prridhë kohore të këtij viti janë ngritë në 52,82%. Çka do të thotë se kemi një ngritje prej 6,10%.

Angazhimi i saj duhet të drejtohet te faturimi i të dy shërbimeve për ti përmirësuar të dhënat e veta operative dhe financiare, si dhe zvogëlim të sasisë së ujërave të humbur.

- **KUR “MITROVICA” Sh. A. Mitrovicë**

Kjo kompani ka tejkaluar sasinë e planifikuar të ujit të prodhuar për 4,34%, gjatë 4 mujorit të parë të këtij viti. Në anën tjetër, faturimin e ujit të furnizuar e ka më të ulët për 8,54% dhe faturimin i grumbullimit të ujërave të zeza po ashtu e ka ma të ulët për 11,55% se sa gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar.

Kur këto të dhëna i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shohim se kompania ka prodhuar ujë ma shumë gjatë vitit 2009 për 2,86%, sikurse që edhe ka faturuar ma shumë vetëm për 0,85% gjatë të njëjtës periudhë krahasimtare. Ndërsa shërbimin e ujërave të zeza nuk e ka të deklaruar për vitin 2008. Kompania është e suksesshme te prodhimi i ujit dhe të kundërtën e ka tek të dy shërbimet tjera. Trendi i përmirësimeve do të ishte ma i mirë sikurse dy shërbimet e kompanisë të kishim rezultate ma të mira.

Humbjet e ujit gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008 kanë qenë 49,81%, ndërsa ato të këtij viti për periudhë të njëjtë humbjet e ujit kanë arrit të jenë 50,82, ose shprehur në % të njëjtat janë ngritë gjatë këtij viti për 1,01% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

- **KUR “HIDRODRINI” Sh. A. Pejë**

Prodhimin e ujit të planifikuar për periudhën e shikuar, kjo kompani e ka ma të ulët për 5,45%, sikurse që e ka ma të ulët edhe faturimin e tij për 9,53% për të njëjtën periudhë kohore. Ndërsa, për grumbullim të ujërave të zeza kompania nuk ka dhënë të dhëna të tilla.



Kur këto të dhëna i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shohim se kompania për këtë periudhë kohore ka prodhuar ma pak ujë gjatë këtij viti në krahasim me vitin paraprak për 6,58%. Po ashtu, kjo kompani edhe ka faturuar ma pak gjatë kësaj periudhe të vitit 2009 për 8,54% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2008. Kompania nuk ka ofrua të dhëna krahasuese për ujërat e zeza.

Humbjet e ujit gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008 kanë qenë 74,52% dhe të njëjtat gjatë këtij viti janë ngritë në 75,05%. Çka do të thotë se kemi një ngritje të humbjeve të ujit prej 0,53%.

Angazhimi i saj duhet të drejtohet te faturimi i të dy shërbimeve, zvogëlimin e humbjeve të ujit, mbajtjen e shënimeve për kosto grupet e shërbimeve etj. Kjo gjendje mund të shkaktoj vështirësi financiare.

- **KUR "RADONIQI" Sh. A. Gjakovë**

Kjo kompani as një nga treguesit e planifikuar nuk i ka përmbushë gjatë 4 mujorit të parë të këtij viti. Prodhimi i ujit ka ngecë pa u përmbushë për 20,28%, faturimi i ujit të furnizuar për 32,16% dhe grumbullimi i ujërave të zeza për 12,22%.

Kur këto të dhëna i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shohim se kompania ka prodhuar ujë ma pak gjatë vitit 2009 për 16,96%, sikurse që edhe ka faturuar ma pak ujë për 6,65%. Ndërsa, të dhënat për ujëra të zeza nuk i ka të deklaruar.

Humbjet e ujit gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008 kanë qenë 62,48%, ndërsa gjatë kësaj periudhe kohore të këtij viti për 57,82%. Çka do të thotë se kemi një zbritje të humbjeve të ujit për 4,66% e që është rast i vetëm nga të gjitha kompanitë e shikuara.

Angazhimi i saj duhet të drejtohet tek të tre treguesit për ti përmbush synimet e saja të planifikuara për këtë vit, përndryshe edhe kjo kompani mund të vijë në vështirësi financiare sipas të dhënave të dala.

- **KUR "HIDROREGJIONI JUGOR" Sh. A. Prizren**

Prodhimin e ujit të planifikuar për periudhën e shikuar është ma lartë për 24,55%, ndërsa faturimi i ujit është ma i ulët për 14,98%. Kompania për grumbullim të ujërave të zeza nuk ka deklaruar ndonjë të dhënë.

Kur këto të dhëna i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shohim se kompania ka prodhuar ujë ma shumë gjatë vitit 2009 për 25,04%, ndërsa, ka faturuar ma pak ujë se gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2008 kur krahasohet me periudhën e njëjtë të vitit 2009 për 5.99%. Të dhënat për ujëra të zeza as në këtë rast nuk janë deklaruar.

Humbjet e ujit gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008 kanë qenë 41,61%, ndërsa për periudhën e njëjtë kohore të këtij viti kjo e dhënë është ngritë në 56,10%. Çka do të thotë se kemi një ngritje të humbjeve të ujit prej 14,49% gjatë vitit 2009.

Angazhimi i kompanisë duhet të drejtohet te ngritja shumëve të faturimit te të dy shërbimet, sikurse që duhet zvogëluar dukshëm edhe humbjet e ujit të cilat janë shumë të larta dhe mund të shkaktojnë vështirësi financiare në të ardhmen e afërt.

- **KUR “BIFURKACIONI” Sh. A. Ferizaj**

Kjo kompani as një nga treguesit e planifikuar nuk i ka përmbushë gjatë periudhës së shikuar të vitit 2009. Prodhimi i ujit ka ngecë për 13,83% dhe faturimi i ujit të furnizuar për 36,49%. Ndërsa, për grumbullim të ujërave të zeza kompania nuk ka dhënë të dhëna të tilla.

Kur këto të dhëna i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shohim se kompania ka prodhuar ma shumë ujë gjatë kësaj periudhe të vitit 2009 për 5,75%, ndërsa e njëjta ka faturuar për të njëjtën periudhë kohore ma pak për 18,92%. Ndërsa, të dhënat për ujëra të zeza nuk i ka të deklaruar as për këtë periudhë të shikuar.

Humbjet e ujit gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008 te kjo kompani kanë qenë 47,50%, ndërsa gjatë të njëjtës periudhë kohore të këtij viti të njëjtat janë ngritë në 59,75%. Çka do të thotë se kemi një ngritje prej 12,25%, që duhet të jetë shqetësuese.

Angazhimi i saj duhet të drejtohet tek të tre treguesit për ti përmbush synimet e saja të planifikuara për këtë vit, përndryshe mund të has në vështirësi financiare. Te kjo kompani duhet theksuar se gjatë vitit të kaluar ka lëshua në punë fabrikën e re të përpunimit të ujit si donacion i qeverisë Zvicerane.

- **KUR “HIDROMORAVA” Sh. A. Gjilan**

Prodhimin e ujit të planifikuar për periudhën e shikuar 4 mujore të vitit 2009 është ma i ulët për 24,45%, sikurse që është edhe faturimi i ujit ma i ulët për 43,47%. Ndërsa, për grumbullim të ujërave të zeza kompania nuk ka dhënë të dhëna të tilla.

Kur këto të dhëna i krahasojmë edhe me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shohim se kompania ka prodhuar ujë ma shumë gjatë vitit 2009 për 14,60% dhe po ashtu ka faturuar pak ma tepër se gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008, por, vetëm 0,27%. Ndërsa, të dhënat për ujëra të zeza nuk i ka të deklaruar.

Humbjet e ujit gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008 kanë qenë 49,77%, ndërsa gjatë të njëjtës periudhë kohore të këtij viti humbja e ujit është ngritë për 56,05%. Çka do të thotë se kemi një ngritje prej 6,28%.

Angazhimi i saj duhet të drejtohet në përmbushjen e planeve të prodhimit për vitin 2009. Ngecjet janë të mëdha dhe mund të këtë pasoja të mëdha për kompaninë. Edhe te kjo kompani duhet theksuar se gjatë vitit të kaluar ka lëshua në punë fabrikën e re të përpunimit të ujit si donacion i qeverisë Zvicerane.

#### **4.1.2. TË DHËNAT E PRODHIMIT DHE FATURIMIT NË NIVEL TË SEKTORIT**

Prodhimi sektorial i ujit i planifikuar për periudhën e shikuar të vitit 2009 është ma i ulët për 3,05%, sikurse që është edhe faturimi i ujit ma i ulët për 18,44%. Dhe sasia e ujërave ë zeza të grumbulluara është ma e vogël se ajo e planifikuar për të njëjtën periudhë për 49,75%. Për sa i përket sasisë së ujërave të zeza duhet theksuar se tri kompani nuk e kanë deklaruar të njëjtën dhe për këtë arsye mund të jetë kjo e dhënë aq negative.

Kur këto të dhëna i krahasojmë edhe me periudhën e njëjtë të vitit 2008, shohim se kompanitë kanë prodhuar ujë ma shumë gjatë vitit 2009 për vetëm 3,17%. Ndërsa, sasia e ujit të faturuar ka qenë ma e ulët në nivel të sektorit për vitin 2009 për 5,08% në

krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2008. Ndërsa, sasia e ujërave të zeza të grumbulluara gjatë vitit 2009 është më e lartë për 30,86% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2008.

Humbjet e ujit në nivel të sektorit gjatë vitit 2008 kanë qenë 54,59%, ndërsa gjatë të njëjtës periudhë kohore të këtij viti ato janë ngritë në 58,22%.


Angazhimi i të gjitha kompanive duhet të jetë në drejtim të përmbushjes së treguesve të planifikuar të cilët kanë qenë bazë për përcaktim të tarifave të këtij viti. Ngecjet janë të mëdha dhe mund të kenë pasoja të mëdha për kompanitë.

Te humbjet e ujit duhet përmend vetëm rastin e “Radoniqit” i cili duket ti ketë zvogëluar humbjet kur krahasohen këto dy periudha kohore. Të gjitha analizat e bëra dhe konkludimet e nxjerra janë të bazuara në të dhënat e deklaruara prej KRU-ve.


#### 4.1.3. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE PËR UJIN E PRODHUAR DHE TË FATURUAR

Në vijim të këtij raporti pa ofruar ndonjë koment tonin po i paraqesim në mënyrë figurative neper grafe të dhënat e prodhimit të ujit, shumën e faturimit për këtë periudhë kohore për shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimit veç e veç, për të gjitha kompanitë, me qëllim që të shihen lëvizjet e tyre.


Diagrami Nr. 1. Prodhimi i ujit në m<sup>3</sup>



Diagrami Nr. 2. Uji i faturuar në m<sup>3</sup>



Diagrami Nr. 3. Faturimi i ujërave të zeza në m<sup>3</sup>



#### 4.2. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

Edhe për analizën e grupimit të këtyre të dhënave do të vepohet sikurse e të dhënat operative të prodhimit dhe faturimit të ujit. Do të analizohen ato të dhëna që kanë dallime të theksuara nga të dhënat e planifikuara dhe të aprovuara nga ZRRUM.

Tabela nr. 2 Te dhenat e shpenzimeve operative te KUR-ve

| N r. P. A. S. | Emritimi i KUR-ve  | Të dhënat e shpenzimeve operative | N ja. S. | Kategoritë e shërbimeve |                     |                  |                |                     |                 |
|---------------|--|-----------------------------------|----------|-------------------------|---------------------|------------------|----------------|---------------------|-----------------|
|               |  |                                   |          | Ujë                     |                     |                  | Kanalizim      |                     |                 |
|               |  |                                   |          | Historike               | Aprovuara nga ZRRUM | Realizuar        | Historike      | Aprovuara nga ZRRUM | Realizuar       |
|               |  |                                   |          | 4 muaj të 2008          | 4 muaj të 2009      | 4 muajt të 2009  | 4 muaj të 2008 | 4 muaj të 2009      | 4 muajt të 2009 |
| 1             | "Pristina" Sh.A. Prishtinë (të dhënat 5 mujore)          | Shpenzimet për personelin         | €        | 1,106,460               | 656,395             | 1,065,868        | 34,284         | 77,348              | 37,222          |
|               |  | Shpenzimet e energjisë elektrike  |          | 615,995                 | 346,071             | 944,057          | 3,537          | -                   | 3,840           |
|               |  | Shpenzimet tjera operative        |          | 643,628                 | 1,953,646           | 592,747          | 2,375          | 119,736             | 12,366          |
|               |  | <b>Total shpenzimet operative</b> |          | <b>2,366,083</b>        | <b>2,956,113</b>    | <b>2,602,672</b> | <b>40,197</b>  | <b>197,083</b>      | <b>53,429</b>   |
| 2             | "Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë                              | Shpenzimet për personelin         | €        | 297,621                 | 265,667             | 269,512          | -              | 32,000              | 16,469          |
|               |  | Shpenzimet e energjisë elektrike  |          | 92,921                  | 79,667              | 103,696          | -              | 12,333              |                 |
|               |  | Shpenzimet tjera operative        |          | 221,403                 | 204,667             | 159,621          | -              | 36,667              | 9,603           |
|               |  | <b>Total shpenzimet operative</b> |          | <b>611,945</b>          | <b>550,000</b>      | <b>532,829</b>   | <b>-</b>       | <b>81,000</b>       | <b>26,072</b>   |
| 3             | "Hidrodrini" Sh.A. Shejë                                 | Shpenzimet për personelin         | €        | 243,407                 | 153,200             | 245,830          |                | 29,667              |                 |
|               |  | Shpenzimet e energjisë elektrike  |          | 71,540                  | 50,333              | 83,563           |                | -                   |                 |
|               |  | Shpenzimet tjera operative        |          | 108,021                 | 216,567             | 89,212           |                | 15,333              |                 |
|               |  | <b>Total shpenzimet operative</b> |          | <b>422,969</b>          | <b>420,100</b>      | <b>418,605</b>   | <b>-</b>       | <b>45,000</b>       | <b>-</b>        |
| 4             | "Radoniq" Sh.A. Gjakovë                                  | Shpenzimet për personelin         | €        | 385,118                 | 228,300             | 379,515          |                | 30,667              | 26,620          |
|               |  | Shpenzimet e energjisë elektrike  |          | 44,451                  | 45,333              | 56,632           |                | -                   | -               |
|               |  | Shpenzimet tjera operative        |          | 143,185                 | 297,800             | 131,098          |                | 4,500               | 3,241           |
|               |  | <b>Total shpenzimet operative</b> |          | <b>572,755</b>          | <b>571,433</b>      | <b>567,245</b>   | <b>-</b>       | <b>35,167</b>       | <b>29,861</b>   |
| 5             | "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. Prizren (të dhënat 5 mujore) | Shpenzimet për personelin         | €        | 303,239                 | 276,233             | 340,219          |                | 13,428              | 42,048          |
|               |  | Shpenzimet e energjisë elektrike  |          | 137,660                 | 127,367             | 145,820          |                | 8,700               | 18,021          |
|               |  | Shpenzimet tjera operative        |          | 174,770                 | 128,788             | 98,328           |                | 17,133              | 10,816          |
|               |  | <b>Total shpenzimet operative</b> |          | <b>615,670</b>          | <b>532,388</b>      | <b>584,367</b>   | <b>-</b>       | <b>39,261</b>       | <b>70,885</b>   |
| 6             | "Bifurkacioni" Sh.A. Ferizaj                             | Shpenzimet për personelin         | €        | 158,413                 | 41,863              | 98,386           |                | 22,627              | 32,796          |
|               |  | Shpenzimet e energjisë elektrike  |          | 13,760                  | 5,536               | 11,226           |                | -                   |                 |
|               |  | Shpenzimet tjera operative        |          | 119,991                 | 87,610              | 14,419           |                | 61,751              |                 |
|               |  | <b>Total shpenzimet operative</b> |          | <b>292,163</b>          | <b>135,008</b>      | <b>124,031</b>   | <b>-</b>       | <b>84,378</b>       | <b>32,796</b>   |
| 7             | "Hidromorava" Sh.A. Gjiroftë                             | Shpenzimet për personelin         | €        | 185,138                 | 146,167             | 106,831          |                | 36,533              | 8,691           |
|               |  | Shpenzimet e energjisë elektrike  |          | 35,281                  | 91,582              | 39,810           |                | -                   |                 |
|               |  | Shpenzimet tjera operative        |          | 134,009                 | 82,103              | 88,522           |                | 43,667              | 2,986           |
|               |  | <b>Total shpenzimet operative</b> |          | <b>354,428</b>          | <b>319,852</b>      | <b>235,163</b>   | <b>-</b>       | <b>80,200</b>       | <b>11,677</b>   |
|               | Shuma e operativme e shpenzimeve                         | Shpenzimet për personelin         | €        | 2,679,395               | 1,767,825           | 2,506,161        | 34,284         | 242,269             | 163,846         |
|               |  | Shpenzimet e energjisë elektrike  |          | 1,011,609               | 745,889             | 1,384,804        | 3,537          | 21,033              | 21,861          |
|               |  | Shpenzimet tjera operative        |          | 1,545,008               | 2,971,180           | 1,173,947        | 2,375          | 298,787             | 39,012          |
|               |  | <b>Total shpenzimet operative</b> |          | <b>5,236,012</b>        | <b>5,484,894</b>    | <b>5,064,912</b> | <b>40,197</b>  | <b>562,089</b>      | <b>224,720</b>  |

Në vijim po i analizojmë shkurtimisht edhe të dhënat e shpenzimeve operative për të gjitha KRU-të sipas deklarimeve të tyre dhe në fund të njëjtat po i komentojmë nga perspektiva e DFT/ZRRUM dhe eventualisht do ta nxjerrim konkluzionet për të njëjtat.

#### 4.2.1. SHPENZIMET OPERATIVE SIPAS KRU-ve

- **KUR “PRISHTINA” Sh. A. Prishtinë**

Shpenzimet e pagave të planifikuara për shërbimet e ujit dhe kanalizimit kjo kompani për 5 mujorin e parë të këtij viti i ka tejkaluar për 50,34%, ato të energjisë elektrike për 173,90%, ndërsa shpenzimet tjera operative janë ma të ulëta se ato të planifikuar gjatë kësaj periudhe të vitit 2009 për 70,82%.

Gjithsejtë shpenzimet operative të planifikuara për këtë periudhë kohore të vitit 2009 kanë qenë ma të ulëta për 15,76%, ndërsa kur totalin e këtyre shpenzimeve të këtij viti e krahasojmë me të dhënat e njëjta të vitit të kaluar, të njëjtat janë ngritë për 12,26% gjatë kësaj periudhe të vitit 2009.

Ky ndryshim ka ardhë për shkak të ngritjes enorme të fondit të pagave tek shërbimet e ujësjellësit dhe te shpenzimeve të energjisë elektrike. Kompania duhet ti këtë nën mbikëqyrje ma të madhe këto dy grupime të shpenzimeve se mendojmë se janë shumë ma të larta se ato që janë planifikuar. Ndërsa e njëjta ka dështuar në realizmin e shpenzimeve tjera operative e që është një tregues jo i mirë se mund të shkaktohen vështirësi në shërbimet e saja nëse kështu vazhdohet edhe në të ardhmen.

- **KUR “MITROVICA” Sh. A. Mitrovicë**

Shpenzimet e pagave të planifikuara për të dy shërbimet për 4 mujorin e parë të këtij viti kanë qenë ma të ulëta për 5,15%, ndërsa shpenzimet e energjisë elektrike për të njëjtën periudhë janë tejkaluar për 12,27%. Kur krahasojmë shumën e përgjithshme të shpenzimeve operative të planifikuara për këtë periudhë kohore do të shohim se kemi zvogëlim të tyre në krahasim me planin për 11,43%.

Ndërsa kur krahasojmë shpenzimet e përgjithshme operative të kësaj periudhe të vitit 2008 me të njëjtat të vitit 2009 do të shohim se kemi një zbritje të shpenzimeve të përgjithshme për 8,67%.

Nga shikimi i këtyre të dhënave duket se kompania i ka nën menaxhim të mirë dhe të mbikëqyrura grupimet e këtyre të dhënave. Shpresojmë se kjo nuk bëhet në dëm të nivelit të shërbimit. Inkurajohet kompania të vazhdojë angazhimin e vet në këtë plan.

- **KUR “Hidrodrini” Sh. A. Pejë**

Fondi i pagave për periudhën e planifikuar 4 mujore te këtij viti kjo kompani e ka tejkaluar për 34,43%, sikurse janë ngritë edhe shpenzimet e energjisë elektrike për të njëjtën periudhë për 66,02%, ndërsa shpenzimet tjera operative kanë mbet pa u realizuar për 61,53%. Kjo ka mundësuar që kompania shumën e përgjithshme operative ta këtë ma të ulët për 10,00% për të njëjtën periudhë kohore të shikuar.

Ndërsa kur krahasohen vitet 2008 me vitin 2009 për të njëjtën periudhë kohore kemi një zbritje të shumës së shpenzimeve të përgjithshme operative për 1,03% gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008.

Kompania do të vepronte mirë sikur të ketë nën kontroll ma të mirë ekuilibrimin e shpërndarjes së shpenzimeve brenda grupimeve të caktuara për të mos ulur nivelin e shërbimit. Përndryshe, shumën e shpenzimeve është në proporcion me shumën e

planifikuar dhe në këtë drejtim inkurajohet kompania ti ruaj të dhënat e planifikuara të këtij viti pasi që kanë pas ndikim të drejtpërdrejtë në tarifa.

Kërkohet nga kompania që të mbaj të dhëna të ndara për të dy shërbimet, se është evidente se për shërbimet e kanalizimit nuk ka prezantuar as një të dhënë dhe kjo është në kundërshtim me metodën e mbajtjes së të dhënave sipas kontabilitetit rregullatorë të aprovuar.

- ***KUR “RADONIQI” Sh. A. Gjakovë***

Kjo kompani ka tejkuluar shumën e shpenzimeve të planifikuar për fondin e pagave për 4 muajt e parë të kësaj periudhe kohore të vitit 2009 për 56,83%, të energjisë elektrike për 24,92%, ndërsa shpenzimet tjera operative i ka ma të ulëta për 55,56% dhe shumën e të gjitha shpenzimeve të këtij grupimi e ka ma të ulët për 1,57%.

Kur krahasohen shumat e përgjithshme të shpenzimeve operative të kësaj periudhe për vitet 2008 dhe 2009 kemi një ngritje të tyre gjatë vitit 2009 për 4,25%.

Sikurse te disa kompani të ngjashme edhe kjo është evidente se struktura e shpenzimeve është e njëjtë duke i ngritë fondin e pagave dhe të energjisë elektrike në mënyrë enorme dhe zvogëlim të shpenzimeve tjera operative e cila mund të ndikojë në zbritjen e nivelit të shërbimeve, gjë që nuk është mirë.

Supozojmë se kompania do ti këtë parasysh ekuilibrimin e këtij disproporcioni për mos krijim të kushteve për uljen e nivelit të shërbimeve. Sikurse që duhet të ketë parasysh se për këtë periudhë kohore janë tejkuluar shpenzimet e planifikuara për vitin 2009 për 4,25%, me tregues negativë për këtë periudhë të shikuar.

- ***KUR “HIDROREGJIONI - JUGOR” Sh. A. Prizren***

Kjo kompani ka tejkuluar shumën e shpenzimeve të planifikuara për paga për 5 muajt e parë të kësaj periudhe kohore të vitit 2009 për 31,97%, të energjisë elektrike për 20,41%, ndërsa shpenzimet tjera operative i ka ma të ulëta për 25,20%, ndërsa shumën e të gjitha shpenzimeve të planifikuara të këtij grupimi e ka ma të lartë për 14,62%.

Kur krahasohen shumat e përgjithshme të shpenzimeve operative të kësaj periudhe për vitet 2008 dhe 2009 kemi një ngritje të shpenzimeve të tilla gjatë vitit 2009 për 6,43%.

Sikurse te disa kompani të ngjashme edhe te kjo kompani është evidente se struktura e shpenzimeve është e njëjtë, duke e ngritë fondin e pagave dhe të energjisë elektrike në mënyrë enorme dhe zvogëlim të shpenzimeve tjera operative e cila mund të ndikojë në zbritjen e nivelit të shërbimeve, gjë që nuk është mirë.

Supozojmë se edhe kjo kompani do ti këtë parasysh ekuilibrimin e këtij disproporcioni për mos me krijuar pasoja jo të mira për nivelin e shërbimeve. Sikurse që duhet të ketë parasysh se për këtë periudhë kohore janë tejkuluar shpenzimet dhe ti sjellë ato në nivelin e planifikuar të tyre, sidomos fondin e pagave.

- ***KUR “BIFURKACIONI” Sh. A. Ferizaj***

Edhe kjo kompani ka tejkuluar shumën e shpenzimeve të planifikuara për paga për 4 muajt e parë të kësaj periudhe kohore të vitit 2009 për 103,41%, sikurse që ka tejkuluar edhe shumën e shpenzimeve të energjisë elektrike për 102,78% për këtë periudhë të vitit 2009, ndërsa shpenzimet tjera operative i ka ma të ulëta për 90,35% dhe shumën e

të gjitha shpenzimeve të këtij grupimi e ka ma të ulët për të njëjtën periudhë për 28,52%.

Kur krahasohen shumat e përgjithshme të shpenzimeve operative të kësaj periudhe për vitet 2008 dhe 2009 kemi një ulje të tyre gjatë vitit 2009 për 46,32%, për të cilat gjë ne nuk i dimë shkaqet e saja.

Sikurse te disa kompani të ngjashme edhe kjo është evidente se struktura e shpenzimeve është e njëjtë duke ngritë fondin e pagave dhe të energjisë elektrike në mënyrë enorme dhe zvogëlim të shpenzimeve tjera operative e cila mund të ndikojë në zbritjen e nivelit të shërbimeve edhe te kjo kompani, gjë që nuk është mirë. Te kjo kompani duhet theksuar se planifikimi i shpenzimeve të përgjithshme nuk ka qenë adekuat real dhe i drejtë pasi që kemi zvogëlim të totalit të shpenzimeve kur krahasohen të dhënat e vitit 2008 dhe ato të vitit 2009 për periudhë të njëjtë kohore.

Mendojmë se Kompania do të duhej të kishte parasysh ekuilibrimin e këtij disproporcioni dhe mos të krijohen pasoja jo të mira për nivelin e shërbimeve.

- **KUR "HIDROMORAVA" Sh. A. Gjilan**

Kjo kompani shumë e shpenzimeve të planifikuara për paga për 4 muajt e parë të kësaj periudhe kohore të vitit 2009 e ka pas ma ulët për 36,77%, ndërsa shumë e shpenzimeve të energjisë elektrike e ka ma të ulët nga ajo e planifikuar për të njëjtën periudhë kohore për 56,53%, ndërsa shpenzimet tjera operative i ka deklaruar të jenë ma të ulëta për 54,22% dhe totali i të gjitha shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë kohore për këtë grupimi e ka ma të ulët për 38,59%.

Kur krahasohen shumat e përgjithshme të shpenzimeve operative të kësaj periudhe për vitet 2008 dhe 2009 kemi një zbritje të tyre nga shuma e planifikuar e të njëjtës periudhë për 30,36%.

Kjo kompani ka udhëheqë një politikë shumë konzervative pasi që fondin e pagave e ka deklaruar të jetë dukshëm ma e ulët nga shuma e planifikuar të shpenzimeve të tilla dhe ky është një veprim shumë i kundërt me kompanitë tjera, edhe shpenzimet tjera operative dukshëm janë ma të ulëta për të njëjtën periudhë kohore.

Kompania do të duhej të ketë kujdes të mos ulë shpenzimet e përgjithshme operative në masën që do mund të ndikon në zbritjen e nivelit të shërbimeve, gjë që është e papranueshme për ZRRUM.

Kjo mund të na çojë te konkludimi i mundshëm se kompania me rastin e planifikimit për këtë vit kalendarik i ka mbivlerësuar shumë e shpenzimeve operative, gjë që mund të jetë me pasoja për të ardhmen, se të njëjtat i kanë ngarkuar tarifën. Supozojmë se kompania do ti ketë parasysh ekuilibrimin e këtij disproporcioni për mos me krijuar pasoja jo të mira për nivelin e shërbimeve.

#### **4.2.2. SHPENZIMET OPERATIVE NË NIVEL TË SEKTORIT**

Shpenzimet operative sektoriale të planifikuara për periudhën e shikuar të vitit 2009 të fondit të pagave për të dy shërbimet janë ma të larta për 32,83%, energjia elektrike për të njëjtën periudhë janë ngritë mbi sasinë e planifikuar për 88,56 3,42%. Ndërsa shpenzimet tjera operative janë ma të ulëta për 62,91%.



Kur krahasojmë shpenzimet e përgjithshme të planifikuara në nivel të sektorit për këtë periudhë kohore të vitit 2009 të njëjtat janë ma të ulëta se shuma e lejuar për 12,52%.

Nëse i krahasojmë shpenzimet e përgjithshme operative të vitit të kaluar me ato të këtij viti për të njëjtën periudhë kohore shihet të njëjtat gjatë kësaj periudhe jenë ma të larta për vetëm 1,02%.


Me përjashtime të caktuara kompanitë duhet të përqendrohen në balancimin e shpenzimeve të veta nga një grupim te tjetri.

Është evidente se fondet e pagave të shumica e kompanive është tejkaluar dukshëm, sikurse që janë tejkaluar dhe shpenzimet për energjinë elektrike. Duket se këto grupime të shpenzimeve janë ngritë në dëm të shpenzimeve tjera operative, gjë që mund të jetë me rrezik të theksuar për zvogëlim të nivelit të shërbimit në kuadër të cilave hynë edhe funksionaliteti teknik i sistemeve të ujësjellësve dhe kanalizimeve.


#### 4.2.3. PARAQITJA GRAFIKE E TË DHËNAVE PËR SHPENZIME OPERATIVE PËR KRU-TË

Edhe këto të dhëna po i paraqesim në mënyrë grafike për çdo kompani veç e veç, me qellim që të shihen lëvizjet e tyre.

Diagrami Nr. 4 Shpenzimet operative për shërbimet e ujësjellësit



Diagrami Nr. 5 Shpenzimet operative për shërbimet e kanalizimit



#### 4.3. TË DHËNAT E FATURIMIT DHE INKASIMIT

Me qellim të kompletimit të pasqyrës së të dhënave kryesore operative dhe financiare të deklaruara nga KRU-të për periudhën 5 mujore të këtij viti, në vijim po i prezantojmë të dhënat e para periodike për shumën e faturimit të çdo kompanie veç e veç dhe shkallën e inkasimit për të njëjtat të përmbledhura për të dy shërbimet (ujësjellës dhe kanalizim), për shkurtimin e pjesës tekstuale të këtij raporti me komentet për çdo njëren prej tyre, duke i përmbledhë pastaj të dhënat për sektorin si tërësi dhe eventualisht me konkluzione të shkurta për të njëjtat.

Tabela Nr. 3 Të dhënat për faturimin dhe inkasimin në vlerë monetare

| Nr. R. e nd.                         | Emri i KUR-ve dhe Lokacioni                                    | Të dhënat financiare | Njësia | Kategoritë e shërbimeve |                     |                  |                |                     |                 |
|--------------------------------------|--|----------------------|--------|-------------------------|---------------------|------------------|----------------|---------------------|-----------------|
|                                      |  |                      |        | Ujë                     |                     |                  | Kanalizim      |                     |                 |
|                                      |  |                      |        | Historike               | Aprovuara nga ZRRUM | Realizuar        | Historike      | Aprovuara nga ZRRUM | Realizuar       |
|                                      |  |                      |        | 4 muaj të 2008          | 4 muaj të 2009      | 4 muajt të 2009  | 4 muaj të 2008 | 4 muaj të 2009      | 4 muajt të 2009 |
| 1                                    | "Prishtina" Sh.A.<br>Prishtinë<br>(të dhënat 5 mujore)         | Faturimi             | €      | 3,430,477               | 4,346,171           | 3,797,889        | 381,095        | 443,747             | 315,299         |
|                                      |  | Inkasimi             |        | 2,270,023               | 3,158,614           | 2,543,029        | 252,225        | 319,584             | 211,037         |
| 2                                    | "Mitrovica" Sh.A.<br>Mitrovicë                                 | Faturimi             | €      | 644,368                 | 679,750             | 696,830          | -              | 119,750             | 78,520          |
|                                      |  | Inkasimi             |        | 582,333                 | 392,328             | 339,155          | -              | 81,725              | -               |
| 3                                    | "Hidrodrini" Sh.A.<br>Pejë                                     | Faturimi             | €      | 758,349                 | 716,043             | 552,839          | -              | 97,898              | 63,556          |
|                                      |  | Inkasimi             |        | 537,241                 | 502,013             | 434,281          | -              | 65,687              | -               |
| 4                                    | "Radoniqi" Sh.A.<br>Gjakovë                                    | Faturimi             | €      | 820,603                 | 1,062,186           | 628,527          | -              | 113,736             | 67,459          |
|                                      |  | Inkasimi             |        | 614,558                 | 816,699             | 499,131          | -              | 97,275              | 43,402          |
| 5                                    | "Hidroregjioni Jugor" Sh.A.<br>Prizren<br>(të dhënat 5 mujore) | Faturimi             | €      | 794,083                 | 810,964             | 767,756          | -              | 122,644             | 110,564         |
|                                      |  | Inkasimi             |        | 552,184                 | 578,042             | 599,213          | -              | 87,295              | 74,060          |
| 6                                    | "Bifurkacioni" Sh.A.<br>Ferizaj                                | Faturimi             | €      | 375,247                 | 361,648             | 259,442          | -              | 102,156             | 43,446          |
|                                      |  | Inkasimi             |        | 259,734                 | 240,708             | 181,953          | -              | 67,346              | 7,200           |
| 7                                    | "Hidromorava" Sh.A.<br>Gjilan                                  | Faturimi             | €      | 371,274                 | 429,215             | 292,660          | -              | 95,160              | 62,701          |
|                                      |  | Inkasimi             |        | 330,972                 | 328,050             | 271,189          | -              | 71,931              | -               |
| <b>Vlera e përgjithme financiare</b> |  | <b>Faturimi</b>      | €      | <b>7,194,401</b>        | <b>8,405,978</b>    | <b>6,995,943</b> | <b>381,095</b> | <b>1,095,091</b>    | <b>741,545</b>  |
|                                      |  | <b>Inkasimi</b>      |        | <b>5,147,045</b>        | <b>6,016,454</b>    | <b>4,867,951</b> | <b>252,225</b> | <b>790,843</b>      | <b>335,699</b>  |

Edhe për analizën e grupimit të këtyre të dhënave do të veprojmë sikurse kemi vepruar te të dhënat operative. Do të analizohen ato të dhëna që kanë dallime të theksuara nga të dhënat e planifikuara dhe të aprovuara nga ZRRUM.

##### 4.3.1. FATURIMI DHE INKASIMI SIPAS KRU-ve

- **KUR "PRISHTINA" Sh. A. Prishtinë**

Planifikimi i faturimit dhe inkasimit të kjo kompani gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008 ka qenë shumë ambiciozë dhe kjo mund të shihet se për 5 muajt e parë të këtij

viti e njëjta ka planifikuar të ngrit shumën e faturimit për vitin 2009 për 39,63% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2008, sikurse që ka planifikuar edhe ngritjen e shumës së inkasimit për të njëjtën periudhë për 197,28%. Synimet e tilla kompania nuk ka mund me i realizuar as për së afërmi.

Por, kur krahasohen të dhënat e planifikuara dhe të realizuara për faturim dhe inkasim për 5 muajt e parë të vitit 2009 kemi mos realizim të planit të faturimit për 14,13% dhe te inkasimit për 20,82%. Nëse i krahasojmë këto të dhëna me dy periudha të njëjta kohore të vitit 2008 dhe atë të vitit 2009 do të shohim se kemi ngritje të shkallës së faturimit 19,90% dhe inkasimit 21,32%.

Duke parë gjendjen ekzistuese, kompania duhet të angazhohet me i përmbush parametrat e planifikuara për këtë vit pasi që të njëjtit kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në tarifën ekzistuese. Këtë e theksojmë edhe për arsye se vet ngritja e tarifës ka ndikuar në ngritjen e shumës së faturimit, pasi që tarifa e të dy shërbimeve të ujit është ngritë për nga 20,00% dhe ajo e kanalizimit është zbrit te shtëpiakët për 40,00% dhe të jo-shtëpiakët është ngritë po ashtu për 40,00% për vitin 2009. Kur kemi parasysh proporcionin e këtyre dy tarifave është evidente se nuk ka ndonjë tregues shpresëdhënës për këtë vit, nëse nuk kemi përmirësime të theksuara gjatë gjysmës së dytë të këtij viti afarist.

- ***KUR “MITROVICA” Sh. A. Mitrovicë***

Edhe kjo kompani sikurse ajo e theksuar te pika 7.1. ka planifikuar një ngritje të shkallës së faturimit dhe inkasimit gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin 2008. Kjo kompani ka qenë ma realist dhe kjo mund të shihet se për 4 muajt e parë të këtij viti e njëjta ka planifikuar të ngrit shumën e faturimit për vitin 2009 për 24,08% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2008, sikurse që ka planifikuar edhe zbritjen e shumës së inkasimit për të njëjtën periudhë për 18,63%. Planifikimi i uljes së shkallës së inkasimit gjatë vitit 2009 në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2008 ka qenë shumë diskutabil por që është dëshmuar të jetë edhe real.

Por, kur krahasohen të dhënat e planifikuara dhe të realizuara për faturim dhe inkasim për 4 muajt e parë të vitit 2009 kemi mos realizim të planit të faturimit për vetëm 3,02% dhe inkasimit për 28,31%. Nëse i krahasojmë këto të dhëna me realizmin e këtyre dy treguesve për vitin 2008 dhe atë të vitit 2009 për të njëjtën periudhë kohore 4 mujore do të shohim se kemi ngritje të shkallës së faturimit 20,33% dhe zbritje të shumës së inkasimit për 41,76%.

Duke parë gjendjen ekzistuese, kompania duhet të angazhohet me i përmbush parametrat e planifikuara pasi që të njëjtit edhe në këtë rast kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në tarifën këtij viti, duke marrë parasysh se tarifa e shërbimit të ujësjellësit për shtëpiakët është ngrit për 7,69%, për jo shtëpiakë për 8,33% dhe për shërbimin e kanalizimit te jo-shtëpiakët për 160,00% gjatë vitit 2009 në krahasim me vitin paraprakë.

Kur kemi parasysh proporcionin e tarifës së ujit është evidente se nuk ka ndonjë përmirësim të theksuar të gjendjes, nëse e njëjta nuk tejkalohet gjatë gjysmës së dytë të këtij viti afarist.

- ***KUR “Hidrodrini” Sh. A. Pejë***

Kjo kompani ka qenë shumë ma e përmbajtur në planet e veta për këtë vit afarist dhe kjo shihet edhe në këtë rast, pasi që shumën e faturimit për vitin 2009 e ka planifikuar

se do ta ngritë për 7,33% dhe inkasimit për 5,69% për 4 muajt e parë të këtij viti, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Edhe për kundër faktit se kjo kompani ka qenë me e përmbajtur në planet e saja për këtë vit për sa i përket shumës së faturimit dhe asaj të inkasimit, prapë se prapë e njëjta ka dështuar që ti përmbush synimet e veta planifikuese dhe atë të shërbimet e ujit për 4 muaj në krahasim me planin kemi faturim ma të ulët për 24,27% dhe inkasim ma të pakët për 23,52%. Që të dy këto të dhëna janë larg nga përmbushja e tyre dhe duhet angazhim shtesë për këtë qellim. Kompania këta dy treguese i ka negativë edhe në krahasim me vitin e kaluar. Nëse e krahasojmë faturimin dhe inkasimin gjatë dy periudhave të njëjta kohore të vitit 2008 dhe 2009 kemi faturim ma pakë për 18,77% dhe inkasim ma të ulët 19,17%.

Duke parë gjendjen ekzistuese, kompania duhet të angazhohet me i përmbush parametrat e planifikuar pasi që edhe përkundër ngritjes ma të përmbajtur të planeve të faturimit dhe inkasimit, të dhënat e realizuara për 4 muajt e parë të këtij viti nuk janë shumë shpresëdhënës, përkundër faktit se edhe në këtë rast kemi pas ngritje të përmbajtur të tri tarifave të cilat kanë ndikuar në ngritjen e shumës së faturimit. Tarifa për shërbimet e ujit te shtëpiakët është ngritë vetëm 4, 76% dhe për shërbimet e ujërave të kanalizimit te jo-shtëpiakët për 40,00% ose nga 0,05 në 0,07 €/m<sup>3</sup>, sikurse që është ngritë edhe tarifa fikse për konsumatorët jo-shtëpiakë nga 2,00 në 3,00 €/muaj, në krahasim me vitin paraprak 2008.

Është evidente se kompania ka dështuar me i përmbush që të gjithë treguesit e planifikuar të këtij viti.

- ***KUR "RADONIQI" Sh. A. Gjakovë***

Edhe kjo kompani në planet e veta të këtij viti ka synuar ngritje të theksuara të shumave të faturimit dhe inkasimit dhe për 4 muajt e parë të këtij viti del të ketë qenë larg nga realitetet e tanishëme. "Radonqi" ka planifikuar një ngritje të shumës së faturimit dhe inkasimit gjatë kësaj periudhe të vitit 2009 në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, dhe atë; shumën e faturimit për shërbimet e ujit gjatë vitit 2009 ishte planifikuar të jetë më lartë për 43,26% dhe atë të inkasimit për 48,72% në krahasim me vitin 2008. Që të dy këto të dhëna janë larg nga përmbushja e tyre sipas të dhënave të dala.

Por, kur krahasohen të dhënat e planifikuara dhe të realizuara për faturim dhe inkasim për 4 muajt e parë të vitit 2009, kemi mos realizim të planit të faturimit për të dy shërbimet, dhe atë; për faturim 40,81% dhe për inkasimit për 40,64%.

Nëse këto të dhëna i krahasojmë për periudhat e njëjta të viteve 2008 dhe 2009 do të shohim se as këto të dhëna nuk janë përmbushë pasi që; shuma e faturimit është ma e ulët për 15,21% dhe për shuma e inkasimit për 11,72% se të dhënat e tilla të realizuara gjatë vitit të kaluar.

Duke parë gjendjen ekzistuese edhe kjo kompani duhet me u angazhua shumë më tepër në përmbushjen e këtyre parametrave të planifikuar, pasi që edhe në këtë rast kemi pas ngritje të tri tarifave për vitin 2009 në krahasim me vitin 2008, të cilat kanë ndikuar sado pak në ngritjen e shumave të faturimit dhe inkasimit të këtij viti. Nëse shikohet nga kjo prizëm, efektet e tilla janë të pa favorshme. Kompanisë i duhet angazhim shumë ma i madh për të zënë hapin e humbur për shërbimet që i ofron.

- **KUR “HIDROREGJIONI - JUGOR” Sh. A. Prizren**

Rasti edhe i kësaj kompanie është pak ma specifik, pasi që e njëjta ka qenë ma e përmbajtur në planet e veta për këtë viti afarist dhe kjo shihet nga krahasimi që u janë bërë grupimit të dhënave të shumave të faturimit dhe inkasimit mes viteve 2008 dhe 2009, për 5 muajt e parë të këtij viti. Me planin e vitit 2009 ishte planifikuar se faturimi do të ngritët për 18,66% dhe inkasimi për 20,49%.

Kur shikohen të dhënat e këtij viti shohim se kjo kompani ka tre tregues pozitivë dhe një negativë për faturim dhe inkasim dhe dallohet si e vetme në këtë sektor për këtë periudhë kohore.

Kompania shumë e planifikuar të faturimit për vitin 2009 për 5 muajt e parë të këtij viti ka ma të ulët për 5,92%, ndërsa kjo kompani është e vetmja në sektor që e ka tejkaluar shumën e planifikuar të inkasimin për 1,19%.

Kur krahasohen të dhënat e planifikuar të viteve 2008 dhe atë të vitit 2009 për shumat e tilla do të shohim se edhe në këtë rast kemi tejkalim të dhënave të realizuar gjatë vitit 2008, te faturimi për 11,17% dhe te inkasimi për 21,93%.

Edhe të dhënat e kësaj kompania edhe pse në shumicë janë më pozitive, të njëjtat janë ndikuara në masë të madhe nga ngritja e katër tarifave të shërbimit për këtë vit dhe një zbritje simbolike të tarifës për shërbimet e kanalizimit. Inkurajohet kompania të vazhdojë në këtë drejtim edhe gjatë gjysmës së dytë të këtij vitit afarist.

- **KUR “BIFURKACIONI” Sh. A. Ferizaj**

Edhe kjo kompani ka qenë ambicioze me rastin e planifikimit të dhënave të veta për vitin 2009, kur ato krahasohen me vitin 2008. Kjo shihet nga krahasimi që u janë bërë grupimit të dhënave të shumës së faturimit dhe inkasimit për vitin 2008 dhe vitin 2009, të cilat janë përpunuar për 4 muajt e parë të këtij viti, pasi që shuma e faturimit ishte planifikuar se do të jetë ma e lartë për 23,60% dhe inkasimit për 18,60%.

Kjo kompani të gjithë treguesit e planifikuar për vitin 2009 i ka negativë dhe të njëjtit ishin larg nga përmbushja e tyre për këtë periudhë të shikuar kohore. Kompania shumë e planifikuar të faturimit për 4 muajt e parë të këtij viti ka dështuar ta përmbush për 34,69% dhe te inkasimi për 39,60%. Këta dy tregues janë jashtëzakonisht të disfavorshëm.

Kur krahasohen të dhënat e planifikuara të viteve 2008 dhe atë të vitit 2009 për shumat realizuara për faturim dhe inkasim për të njëjtën periudhë 4 mujore, shohim se edhe në raport me të dhënat e të njëjtës periudhë të vitit 2008 kemi të dhëna negative, dhe atë: te faturimi për 19,28% dhe te inkasimi për 27,17%, çka do të thotë se kompania ka dështime të thella në realizimin e këtyre të dhënave. Kjo është edhe më pak e favorshme edhe për faktin se edhe te kjo kompani kemi pas ngritje të dy tarifave të shërbimeve të kanalizimit për vitin 2009.

Me qellim të realizimit të synimeve të veta “Bifurkacioni” duhet të bëjë përpjekje shtesë për të përmirësuar këtë gjendje, përndryshe mund të vij në vështirësi të cilat do ta rëndojnë afarizmin e saj.

- **KUR "HIDROMORAVA" Sh. A. Gjilan**

Edhe te kjo kompani të dhënat analizohen për 4 muajt e parë të këtij viti, dhe e njëjta ka qenë tejet ambicioze me rastin e planifikimit të dhënave të veta për vitin 2009, kur ato krahasohen me vitin 2008. Ky konkludim vjen nga fakti se shumat e faturimit dhe inkasimit për vitin 2009 janë planifikuar të jenë ma të larta; për faturim 41,24% dhe për inkasim 20,85% , në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Edhe kjo kompani që të gjithë treguesit e planifikuar për vitin 2009 i ka negativë dhe ishte larg nga përmbushja e tyre për këtë periudhë kohore.

Kompania shumat e planifikuar të faturimit dhe inkasimit për vitin 2009 për të njëjtën periudhë të këtij viti ka dështuar ta përmbush, te faturimi për 32,31% dhe të inkasimit për 32,20% që është jashtëzakonisht larg parametrave të dëshiruara.

Kur krahasohen të dhënat e planifikuara të viteve 2008 dhe atë të vitit 2009 për shumat realizuara për faturim dhe inkasim për njëjtat periudhë 4 mujore, shohim se edhe në raport me të dhënat e të njëjtës periudhë të vitit 2008 kemi të dhëna negative, dhe atë: faturimi është ma i ulët për 18,56% dhe inkasimi për 23,55%, çka do të thotë se kompania ka dështuar me e realizuar edhe planin e vitit 2008 e lërë më atë të vitit 2009. Edhe te kjo kompani kemi pas ngritje të theksuar të pesë tarifave, te konsumatorë shtëpiakë për dy tarifa kemi pas ngritje të saj prej 16,67% dhe të konsumatorët jo-institucional te dy tarifa tjera për 27,27% dhe një tarifën fikse nga 2,00 €/muaj në 3,00€/muaj për konsumatorët jo-shtëpiakë për vitin 2009.

Me qellim të realizimit të synimeve të veta edhe kjo kompani duhet të bëjë përpjekje shtesë për të përmirësuar këtë gjendje, përndryshe mund të vij në vështirësi të cilat e rëndojnë afarizmin e saj.

#### **4.3.2. TË DHËNAT FATURIM DHE INKASIM NË NIVEL TË SEKTORIT**

Fillimisht do të shikojmë dhe bëjmë krahasimet e nevojshme sektoriale në mes të shumave të faturimit dhe të inkasimit për periudhat e shikuara kohore të vitit 2008 dhe 2009. Planifikimet e kompanive kanë qenë shumë ambicioze për këto të dhëna për vitin 2009 dhe si të tilla duhet thënë me një përjashtim kanë mbet larg nga realizimi i tyre. Kjo për faktin se është planifikuar një ngritje e shumës së faturimit gjatë vitit 2009 për 32,06% dhe inkasimit për 32, 26% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2008.

Të dhënat sektoriale tregojnë se shuma e faturimit ka qenë ma e ulët se shuma e planifikuar për këtë periudhë kohore për vitin 2009 për 18,56%. Ndërsa shuma e inkasimit ka qenë edhe ma e ulët se shuma e planifikuar për të njëjtën periudhë kohore për 23,55%.

Këto të dhëna na tregojnë se faturimi dhe inkasimi gjatë kësaj periudhe kohore të vitit 2009 në krahasim me vitin 2008 është tejkaluar; te faturimi vetëm për 7,55% dhe te inkasimi vetëm për 1,10%. Që të dy këta tregues janë shumë larg nga shumat e planifikuara për tu përmbushë.

Ngritjet e tilla janë më dekurajuese edhe për faktin se që të gjitha janë ndikuar nga ngritjet e tarifave në sektorë, diku ma tepër e diku ma pak.

Për me e ndryshua këtë gjendje kompanitë duhet të bëjnë angazhime shtesë për të përmirësuar performancën e vetë, përndryshe reperkusionet janë të pa evitueshme se në to kanë ndikuar tarifat e këtij viti.

#### 4.4. ANALIZA E INVESTIMEVE KAPITALE

Edhe për analizën e grupimit të këtyre të dhënave do të veprojmë sikurse kemi vepruar te të dhënat tjera të përshkruara më lartë. Të njëjtat do të pasqyrohen për 5 mujorin e parë të vitit 2008 dhe për të njëjtën periudhë të vitit 2009, për çdo kompani veç e veç, në të cilat janë shumat e investimeve të lejuara nga rregullatori dhe ndaras ato të realizuara për periudhën e shikuar 5 mujore të vitit 2009.

Të dhënat e pasqyruar në Tabelën Nr. 4., janë të kategorizuara për dy llojet të shërbimeve, dhe atë për; shërbimet e ujësjellësit dhe për shërbimet e kanalizimit, të cilat janë ndarë në asetet infrastrukturore dhe jo-infrastrukturore, pastaj të njëjtat janë definuar edhe për kah forma e planifikuar e financimit, në investime vetjake dhe nga donatorët potencial.

Pas këtyre kategorizimeve DFT/ZRRUIM për vitin 2009 ka bërë edhe këto pasqyrime, si shumën e projekteve të planifikuara nga KRU-të dhe të lejuara nga ZRRUM për realizim nga burimet vetjake të financimit dhe shumën e projekteve të realizuar për këtë periudhë kohore nga këto dy burime financimi.

Të dhënat e tilla do të analizohen shkurtimisht dhe do të komentohen me qëllim të ndërmarrjes së masave për përmirësim të gjendjes ekzistuese të shumica e kompanive, pasi që kjo është e evidente se nuk është e mirë për këtë periudhë të shikuar.

Edhe këto të dhëna po i paraqesim në formë tabelore me qëllim krahasimi më të lehtë të të dhënave të tilla të marra nga kompanitë dhe si zakonisht të njëjtat do të përmbliken dhe trajtohen si të dhëna sektoriale për këto kompani.

Edhe për analizën e grupimit të këtyre të dhënave do të veprojmë sikurse kemi vepruar me të dhënat tjera. Të njëjtat do të analizohen, komentohen dhe shkurtimisht do të nxirren konkluzione me synim të përmirësimit të kësaj gjendje në pjesën e dytë të këtij viti, me që rast do të theksojmë edhe implikimet e mundshme për mos realizim të tyre.

Tabela Nr.4 Investimet kapitale të planifikuara, të lejuara nga DFT/ZRRUM dhe të realizuara nga kompanit për 5 muajt e parë të procesit tarifor 2009 në €

| Të dhënat e kompanive                  | Investimet        | Ujë              |                   |                   | Kanalizim        |                   |                   | Shuma e Investimeve të planifikuara nga kompania për 2009 | Shuma e Investimeve vetanake të lejuara me tarifen e vitit 2009 | Projektet e realizuara në 5 mujorin e parë të 2009 |                  |
|--|-------------------|------------------|-------------------|-------------------|------------------|-------------------|-------------------|---|---|--|------------------|
|  |                   | Vetanake         | Donacione         | Totali            | Vetanake         | Donacione         | Totali            |   |   | Vetanake   | Donacione        |
| "Prishtina" Sh.A.<br>Prishtinë         | Infrastrukturë    | 1,159,600        | 6,629,000         | <b>7,788,600</b>  | 152,000          | -                 | <b>152,000</b>    | 7,940,600   | 1,679,746   | 100,512  |                  |
|  | Jo-Infrastrukturë | 1,315,800        | 7,840,000         | <b>9,155,800</b>  | 216,900          | 1,698,200         | <b>1,915,100</b>  | 11,070,900  |   |  |                  |
|  | <b>Totali</b>     | <b>2,475,400</b> | <b>14,469,000</b> | <b>16,944,400</b> | <b>368,900</b>   | <b>1,698,200</b>  | <b>2,067,100</b>  | <b>19,011,500</b>   |   |  |                  |
| "Mitrovica" Sh.A.<br>Mitrovicë         | Infrastrukturë    | 210,850          | 312,800           | <b>523,650</b>    | 8,700            | 71,700            | <b>80,400</b>     | 604,050   | 268,132   | -  | -                |
|  | Jo-Infrastrukturë | 512,100          | 139,000           | <b>651,100</b>    | 9,300            | -                 | <b>9,300</b>      | 660,400   |   |  |                  |
|  | <b>Totali</b>     | <b>722,950</b>   | <b>451,800</b>    | <b>1,174,750</b>  | <b>18,000</b>    | <b>71,700</b>     | <b>89,700</b>     | <b>1,264,450</b>  |   |  |                  |
| "Hidrodrini" Sh.A.<br>Pejë             | Infrastrukturë    | 452,000          | 410,000           | <b>862,000</b>    | 19,000           | -                 | <b>19,000</b>     | 881,000   | 352,766   | 56,506   | 760              |
|  | Jo-Infrastrukturë | 170,500          | 60,000            | <b>230,500</b>    | 15,000           | -                 | <b>15,000</b>     | 245,500   |   |  |                  |
|  | <b>Totali</b>     | <b>622,500</b>   | <b>470,000</b>    | <b>1,092,500</b>  | <b>34,000</b>    | <b>-</b>          | <b>34,000</b>     | <b>1,126,500</b>  |   |  |                  |
| "Radoniqi" Sh.A.<br>Gjakovë            | Infrastrukturë    | 133,000          | 252,000           | <b>385,000</b>    | 57,675           | -                 | <b>57,675</b>     | 442,675   | 957,050   | 3,666  |                  |
|  | Jo-Infrastrukturë | 600,000          | 1,650,000         | <b>2,250,000</b>  | -                | -                 | <b>-</b>          | 2,250,000   |   |  |                  |
|  | <b>Totali</b>     | <b>733,000</b>   | <b>1,902,000</b>  | <b>2,635,000</b>  | <b>57,675</b>    | <b>-</b>          | <b>57,675</b>     | <b>2,692,675</b>  |   |  |                  |
| "Hidroregjioni Jugor"<br>Sh.A. Prizren | Infrastrukturë    | 260,800          | 1,555,894         | <b>1,816,694</b>  | 197,200          | 5,250,000         | <b>5,447,200</b>  | 7,263,894   | 383,810   | 12,300   |                  |
|  | Jo-Infrastrukturë | 244,800          | 1,500,332         | <b>1,745,132</b>  | 50,000           | 5,000,000         | <b>5,050,000</b>  | 6,795,132   |   |  |                  |
|  | <b>Totali</b>     | <b>505,600</b>   | <b>3,056,226</b>  | <b>3,561,826</b>  | <b>247,200</b>   | <b>10,250,000</b> | <b>10,497,200</b> | <b>14,059,026</b>   |   |  |                  |
| "Bifurkacioni" Sh.A.<br>Ferizaj        | Infrastrukturë    | 492,000          | 425,000           | <b>917,000</b>    | 218,800          | -                 | <b>218,800</b>    | 1,135,800   | 663,012   | 5,764  | 1,032,371        |
|  | Jo-Infrastrukturë | 252,000          | -                 | <b>252,000</b>    | 43,200           | -                 | <b>43,200</b>     | 295,200   |   |  |                  |
|  | <b>Totali</b>     | <b>744,000</b>   | <b>425,000</b>    | <b>1,169,000</b>  | <b>262,000</b>   | <b>-</b>          | <b>262,000</b>    | <b>1,431,000</b>  |   |  |                  |
| "Hidromorava" Sh.A.<br>Gjilan          | Infrastrukturë    | 25,000           | 390,000           | <b>415,000</b>    | 25,000           | -                 | <b>25,000</b>     | 440,000   | 93,016  | -  | -                |
|  | Jo-Infrastrukturë | 332,600          | 180,000           | <b>512,600</b>    | -                | -                 | <b>-</b>          | 512,600   |   |  |                  |
|  | <b>Totali</b>     | <b>357,600</b>   | <b>570,000</b>    | <b>927,600</b>    | <b>25,000</b>    | <b>-</b>          | <b>25,000</b>     | <b>952,600</b>  |   |  |                  |
| <b>Totali i investimeve</b>            |                   | <b>6,161,050</b> | <b>21,344,026</b> | <b>27,505,076</b> | <b>1,012,775</b> | <b>12,019,900</b> | <b>13,032,675</b> | <b>40,537,751</b>   | <b>4,397,531</b>  | <b>178,748</b>                                     | <b>1,033,131</b> |

Edhe për analizën e grupimit të këtyre të dhënave do të veprojme sikurse kemi vepruar te të dhënat operative dhe financiare dhe të njëjtat do të analizohen duke i theksuar dallimet mes të dhënave të tilla.



- **KUR “PRISHTINA” Sh. A. Prishtinë**

Kjo kompani ka planifikuar një numër të madh të projekteve me shuma të mëdha të investimeve për tu realizuar gjatë vitit 2009, si nga mjetet vetjake të investimeve po ashtu edhe ato nga donatorët. Mirëpo në mungesë të mbylljes së konstruksionit financiarë të njëjtat kanë mbet vetëm projekte ekzistuese të cilat priten të realizohen në periudha ma të mira të afarizmit të kësaj kompanie dhe të mjedisit rrethues të saj.

ZRRUM me tarifat e këtij viti ka lejuar një shumë dukshëm ma të vogël të investimeve për të dy shërbimet nga burimet vetjake të cilat i kanë ngarkuar tarifat e këtij viti, e cila shprehur në % do të mund të arrinte shumë prej 59,06% të shumës së planifikuar për vitin 2009, nëse përmbushen parametrat e planifikuar të këtij viti afarist të inkorporuar në procesin e përcaktimit të tarifave. Por këto plane janë larg nga realizimi i tyre pasi që për këta 5 muajt e kaluar ato janë realizuar vetëm për 5,98%. Ndërsa nuk ka pas ndonjë projekt të realizuar nga donatorët.

Kompania duhet të angazhohet për realizim të shumës së investimeve të lejuar për këtë vit se do të ngecë me zgjerim të bazës së vet fizike dhe uljes së vlerës financiare të aseteve dhe mund të ndeshet me faktin e zbritjes së tarifës së vitit 2010 për atë shumë të investimit të pa realizuar nga investimet vetanake.

- **KUR “MITROVICA” Sh. A. Mitrovicë**

Edhe kjo kompani ka planifikuar një shumë relativisht të lartë të investimeve për tu realizuar gjatë vitit 2009, si nga mjetet e veta financiare po ashtu edhe nga ato të donatorëve të mundshëm. Duke analizuar rrethanat e përgjithshme, rregulatori për këtë kompani ka lejuar vetëm 36,18% të shumës së planifikuar të investimeve nga burimet vetanake financiare për të dy shërbimet për vitin 2009 e cila do të mund të mbulohej nga tarifat e këtij viti, nëse përmbushen të gjithë parametrat e planifikuar për këtë vit.

Por, gjatë kësaj periudhe të shikuar e njëjta nuk ka realizuar as një shumë të investimeve nga burimet vetanake financiare.

E njëjta nuk ka realizuar as ndonjë projekt të investuar nga donatorët e mundshëm për këtë kohë të shikuar. Edhe për këtë kompani mund ti përshkruhet konkluzioni i theksuar ma lartë, pika 8.1.

- **KUR “Hidrodrini” Sh. A. Pejë**

Edhe “Hidrodrini” ka planifikuar një numër të caktuar të projekteve me shuma relativisht të mëdha të investimeve për realizim gjatë vitit 2009, si nga mjetet vetanake të investimeve po ashtu edhe ato nga donatorët e mundshëm. Mirëpo në mungesë të mbylljes së konstruksionit financiarë, DFT/ZRRUM me tarifat e këtij viti ka lejuar një shumë dukshëm ma të vogël të investimeve nga burimet vetanake e cila mund të realizohej nëse përmbushen parametrat operativo financiarë të këtij viti.

Shuma e investimeve të lejuara për realizim shprehur në % do të mund të arrinte shumë e tërësishme të planifikuar prej 53,73% e cila për këtë periudhë të shikuar është realizuar vetëm për 16,02% për këtë 5 muajt e parë të vitit 2009. Ndërsa as projektet e planifikuara për tu realizuar nga donatorët nuk kanë filluar së realizuar gjerë në momentin e marrjes së shënimeve të tilla nga kompania, përveç shumës minore prej 760,00 €.

Kompania duhet të angazhohet për realizim të shumës së investimeve të lejuar për vitin 2009 se do të ngecë me zgjerim të bazës së vet të aseteve dhe mund të ndeshet me faktin e zbritjes së tarifës së vitit 2010 për atë shumë të investimet të pa realizuara nga investimet vetanake të cilat kanë ndikuar në ngritjen e tarifave.

- ***KUR “RADONIQI” Sh. A. Gjakovë***

Edhe kjo kompani ka planifikuar një numër të caktuar të projekteve me shumë relativisht të lartë të investimeve për mundësit e veta për tu realizuar gjatë vitit 2009, si nga mjetet vetanake të investimeve po ashtu edhe ato nga donatorët e mundshëm.

Rasti i kësaj kompanie është më specifik ngase kompania kishte planifikuar investime ma të pakët në vlerë nga burimet vetanake dhe rregullatori të njëjtën e ka ngritë për 21,04% pas korrigjimeve të bëra te tarifat dhe në të njëjtën kohë është kërkuar që e njëjta fitimin e mbetur ta përdorë për investime kapitale.

Nga shuma e lejuar për investime prej 957.050,00 €, kompania për 5 muajt e parë të këtij viti ka realizuar vetëm 3.666,00 € ose shprehur në % vetëm 0,38%. Edhe te kjo kompani projektet investimeve vetanake mund të realizohen vetëm nëse përmbushen parametrat e planifikuar për këtë vit në masën 100%, gjë që nuk është rasti gjer me tani.

Ndërsa projektet e planifikuara për tu realizuar nga donatorët e mundshëm nuk janë filluar e as që ka ndonjë të realizuar gjatë kësaj periudhe kohore.

Edhe kjo kompani duhet të angazhohet për realizim të shumës së investimeve të lejuar për vitin 2009 se do të ngecë në zgjerim të bazës së vet të aseteve dhe zvogëlim të vlerës së vet financiare të aseteve vetanka dhe mund të ndeshet me faktin e zbritjes së tarifës së vitit 2010 për atë shumë të investimet të pa realizuara nga burimet e veta të financimit.

- ***KUR “HIDROREGJIONI - JUGOR” Sh. A. Prizren***

Edhe “Hidroregjioni-Jugor” kishte planifikuar numër të caktuar të projekteve me shumë caktuar të investimeve kapitale për tu realizuar gjatë vitit 2009, si nga mjetet vetanake të investimeve po ashtu edhe ato nga donatorët potencial.

Mirëpo në mungesë të mbylljes së konstruksionit financiarë, DFT/ZRRUM me tarifat e këtij viti ka lejuar një shumë dukshëm ma të vogël të investimeve nga burimet vetanake e cila shprehur në % do të mund të arrinte shumën e investimeve të planifikuar të viti 2009 prej 50,98% e cila gjerë në momentin e mbledhjes së këtyre dhënave ka realizuar shumën e investimeve për vetëm 3,20% për 5 muajt e parë të këtij viti. As kjo kompani nuk ka realizuar as një projekt të planifikuar nga donatorët e mundshëm për këtë periudhën kohore.

Edhe për këtë kompani mund ti përshkruhet konkluzionet e theksuar si për kompanitë tjera.

- ***KUR “BIFURKACIONI” Sh. A. Ferizaj***

Edhe kjo kompani ka planifikuar një numër të caktuar të projekteve me shumë të caktuara të investimeve për ti realizuar gjatë vitit 2009, si nga mjetet vetanake të investimeve po ashtu edhe ato nga donatorët e mundshëm.

Projektet e planifikuara për realizim nga mjetet vetanak janë në shumë ma të lartë se ato të donatorëve të mundshëm. Kompanisë nuk i është lejuar shuma e kërkuar për financime nga mjetet vetanake, pasi që ajo nuk do të mund të realizojë me tarifën e shërbimit për këtë vit kalendarik.

Por nga shuma e investimeve të planifikuara të njëjës i është lejuar shuma e kërkuar për 82,26% që është rast i rrallë me një % kaq të lartë dhe nga kjo shumë ka realizuar një shumë minore e cila shprehur në % është vetëm 0,87% e cila është e pa përfillshme.

Ndërsa nga projektet e planifikuara për tu realizuar nga donatorët e mundshëm ajo ka tejkaluar shumen e tillë të planifikuar për 5 mujorin e parë të këtij viti, fal projekteve të Kuvendit Komunal i cili ka bërë riparime dhe ndërrim të gypave të ujësjellësit dhe kanalizimit në lokalitet dhe dimensione të caktuara. Ekziston mundësia që disa projekte mos të përmbillen në tërësi gjerë në fund muajt Maj 2009 për të cilën periudhë bëhet ky raport.

Problem në vete për kompaninë është mos realizimi projekteve investive nga burimet e brendshme financiare. Me mos realizimin e projekteve të tilla investive me shumën e investimeve të lejuar nga DFT/ZRRUM, kompania nuk e zgjeron bazën e vet fizike të aseteve dhe e zvogëlon velerën financiare të tyre vit pas viti dhe mund të ndeshet me faktin e zbritjes së tarifës së vitit 2010 për atë shumë të investimeve të pa realizuara e të lejuara nga rregullatori nga burimet e veta financiare.

- **KUR “HIDROMORAVA” Sh. A. Gjilan**

Edhe “Hidromorava” ka planifikuar një numër të caktuar të projekteve investive për tu realizuar gjatë vitit 2009, nga mjetet financiare vetanake dhe nga ato të donatorëve potencial. Kësaj kompanie i është lejuar vetëm 24,31% të shumës së projekteve të planifikuara për realizim nga mjetet e veta financiare dhe nga to nuk ka realizuar as një shumë për periudhën e shikuar 5 mujore të investimeve.

Kjo kompani nuk ka realizuar asnjë projekt investiv as nga mjetet e financiare të donatorëve.

Kompania duhet të angazhohet për realizim të shumës së investimeve të lejuar për vitin 2009 se edhe kjo do të ngecë në zgjerim të bazës së vet të aseteve dhe ulje të vlerës së saj dhe do të mund ndeshet me faktin e zbritjes së tarifës së vitit 2010 për atë shumë të investimet të pa realizuara nga investimet vetanake.

#### **4.4.2. TË DHËNAT SEKTORIALE TË PËRGJITHSHME PËR INVESTIME KAPITALE**

Kur shikohen këto të dhëna nga aspekti historik afatshkurta mund të thuhet se kompanive u janë krijuar parakushtet që të fillojnë të krijojnë fitime të caktuar nga afarizmi i tyre dhe me to të realizojnë projektet të caktuar në shuma relativisht të vogla në përputhje me nevojat e tyre aktuale.

Shuma e projekteve investive të planifikuara për financim nga burimet vetanake nga shtatë kompanitë regjionale të ujësjellësve dhe kanalizimeve të vendit për vitin 2009 ishte 7.173.825 €, të cilën rregullatori e ka korrigjuar duke e sjellë në shumë të

përgjithshme prej 4.397.531 € e cila shprehur në % është 61,29% nga shuma fillimisht e planifikuar e cila mund të mbulohet me tarifën e viti 2009. Nga gjithë kjo shumë e lejuar janë realizuar vetëm 178.748€ ose shprehur në % vetëm 4,06% e që as për së afërmi s'është e mjaftueshëm për të realizuar synimet e pritshme.

Shuma e planifikuar e projekteve dhe investimeve me financim të mundshëm nga donatorët ishte paramenduar se do të arrinte në 33.363.926 € e cila është realizuar për këtë periudhë kohore vetëm për 3,10% që është po ashtu e pa mjaftueshme. I vetmi investim me i ndjeshëm i financuar nga donatorët e mundshëm është bërë në qytetin e Ferizajt, për shkak të rekonstruimit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në disa rrugë të këtij qyteti. Shuma e vlerës së tillë është 1.032.371 €.

Manaxhmentet dhe palët tjera të drejtpërdrejta të interesuar për këtë sektorë duhet të intensifikojnë angazhimin e tyre për realizim të planeve të tyre operative - financiare të kësaj periudhe tri vjeçare se mund të silltë sektori në vështirësi në të ardhmen. Realizimi i planeve operative - financiare të viteve 2009 gjer në fund të vitit 2011 është parakusht për realizim të investimeve nga burimet financiare vetanake.

## **5. KONKLuzionet me Rekomandime**

Ekipet e ZRRUM, gjatë vizitave të realizuara me qëllim të hartimit të këtij raporti, janë pritur mjaft mirë nga KRU-të. Kjo vlerësohet nga ZRRUM si një qasje pozitive dhe bashkëpunuese e KRU-ve të cilat kanë ofruar të gjitha të dhënat që i kishin në dispozicion në momentin e realizimit të vizitave. Sigurisht që gjithmonë ka hapësirë për përgatitje edhe më të mira dhe realizim më të suksesshëm të bashkëpunimit, dhe ZRRUM pret që në vizitat e ardhshme disa prej kompanive do të përgatiten më mirë.

Kur flasim për sasinë e ujit të prodhuar, si dhe sasinë e faturuar për ujin e distribuuar dhe grumbullimin e ujërave të zeza, shohim se as një nga këto nuk është realizuar në përputhje me planin e punës për këtë vit, respektivisht për këtë periudhë kohore. Dështime të theksuar ka të sasia e grumbullimit të ujërave të zeza dhe të faturimit të ujit të prodhuar për këtë periudhë kohore të shikuar. Kur i shikojmë të dhënat e tilla të vitit 2008 me ato të periudhës së njëjtë të këtij viti, shohim se parametrat e prodhimit të ujit dhe faturimit të ujësjellësit është nën të dhënat e vitit 2008, ndërsa faturimi i ujërave të zeza është ngritë në krahasim me vitin 2008 për 31,28%, por që është dukshëm nën planin e këtij viti.

Shpenzimet për paga dhe për energjinë elektrike janë tejkaluar dukshëm tek të gjitha KRU-të, me përjashtim të KRU "Hidromorava" e Gjilanit (për pagat e kësaj periudhe kohore). Ndërsa kemi mosrealizim të shumave të planifikuar të shpenzimeve tjera operative në shumën shumë të lartë, që mund të jetë me pasoja për të ardhmen e afarizmit të këtyre kompanive. KRU-të duhet të angazhohen në ndërrimin e këtij disproporcioni të shpenzimeve të bëra për pjesën e dytë të këtij viti dhe viteve të tjera pasuese.

Edhe realizimi i projekteve investive të dy burimet e investimeve ka dështuar në realizim të planeve të tilla dhe kjo duhet të jetë brengosëse për të gjitha palët e interesuara. Theks të veçantë i japim realizimit të projekteve nga burimet financiare vetjake të kompanive të cilat janë të ndërlidhura me realizim të gjithë parametrave të përcaktuar me procesin tariforë të këtij viti dhe të dy viteve të tjera pasuese.

Angazhimin e DFT të ZRRUM-it në realizimin e këtij monitorimi e konsiderojmë si eksperiencë të mirë dhe të suksesshme, nga ku është fituar një përvojë të re e cila do të na ndihmojë për të konsoliduar të dhënat e nxjerra, si dhe për të përgatitur vizitat e ardhshme të cilat planifikohet të realizohen në gjysmën e dytë të këtij viti.